



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 shkurt 2015
Nr. ref.:RK773/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI137/14

Parashtrues

Shpejtim Ademaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shpejtim Ademaj, me vendbanim në fshatin Jabllanicë, komuna e Gjakovës, i cili momentalisht është duke vuajtur dënimin e tij në burgun e Dubravës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës). Ai përfaqësohet nga z. Gafur Elshani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 maj 2014, bazuar në informatat e pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, P.m.l. nr. 194/2013, të 2 prillit 2014. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, i ka shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ndalim të diskriminimit dhe mjetet juridike, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 shtator 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 18 shtator 2014, parashtruesi dorëzoi, me iniciativën e tij, dokumente shtesë në Gjykatë.
7. Më 7 tetor 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI137/14 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI137/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 27 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin e përfaqësuesit në pajtim me nenin 21 të Ligjit, dhe me rregullin 29 (2) c) të Rregullores së punës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që ta dorëzojë kopjen e fletëdërgesës, që tregon datën kur parashtruesit të kërkesës ose përfaqësuesve të tij u është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar. Në fund, të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
9. Më 3 nëntor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin, siç ishte kërkuar nga Gjykata.

10. Më 4 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi dokumentin e kërkuar në Gjykatë, i cili dëshmon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar, më 23 maj 2014.
11. Më 21 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Gjatë natës në mes të 14 dhe 15 tetorit 2009, një grup prej 18 (tetëmbëdhjetë) qytetarëve nga Kosova e kaloi kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë me barkë në lumin Tisa, në afërsi të qytetit të Suboticës. Varka u përmyt në rrugë e sipër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) shtetas të Kosovës humbën jetën, ndërsa 3 (tre) prej tyre mbijetuan.
13. Më 7 tetor 2010, Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: PSRK) bazuar në aktin PPS. nr. 422/09, ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës dhe 6 (gjashtë) personave të tjerë, duke i akuzuar ata për veprën penale të krimit të organizuar, nga neni 274, paragrafi 4, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme : KPK), dhe veprën penale kontrabandim me emigrantë, nga neni 138, paragrafi 6 i po të njëjtit kod.
14. Më 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë aprovoi Aktgjykimin P. nr. 244/10, me të cilin shpalli parashtruesin e kërkesës *“fajtor për dy vepra penale dhe e dënoi atë, për veprën e parë, me burgim prej 14 (katërmëdhjetë) vjetësh dhe 200,000 €, ndërsa për veprën e dytë me burgim prej 2 (dy) vjetësh për çdo emigrant, domethënë me dënim unik në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobë prej 200,000 €.”*
15. Më 30 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 244/10, në të cilën ai pranoi përgjegjësinë për veprën penale të kontrabandimit të emigrantëve nga neni 138 i KPK-së, por i kundërshtoi akuzat për krim të organizuar. Kështu, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që rasti të kthehet në Gjykatën e Qarkut në rigjykim ose të nxirret një vendim i ri, me të cilin do të shpallej përgjegjës vetëm për kontrabandim të emigrantëve, por jo për krim të organizuar.
16. Të njëjtën ditë, avokati i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë shtesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 244/10 për shkak të *“shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të dispozitave të kodit penal, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në lidhje me vendimin për dënimin penal”.*
17. Më 2 tetor 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin AP-Kz nr. 61/2012, me të cilin u refuzua ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe u konstatua se:

“[...] kolegji i Gjykatës së Qarkut ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike relevante për të gjithë të pandehurit. Për këtë qëllim, Gjykata Supreme e

Kosovës i referohet arsyetimit të aktgjykimit në vërtetimin e saj të fakteve dhe të përgjegjësisë për secilin të pandehur. Nuk ekziston asnjë indikacion se Gjykata e Qarkut nuk ka eksploruar në mënyrë të sigurtë rrethanat e lëndës dhe ka zhvilluar procedurën në mënyrë të drejtë dhe objektive. Gjykata Supreme pajtohet se disa formulime të përdorura nga trupi gjykues mund të duken pak si të paqarta. Sidoqoftë, gjetjet e trupit gjykues nuk janë bazuar në supozime. Gjykata e shkallës së parë në të vërtetë ka arsyetuar mirë vlerësimin e saj të provave, përfshirë besueshmërinë e dëshmitarëve [...] dhe peshën e deklaratave të tyre, për të marrë vendimin mbi fajësinë [...].

18. Më 8 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, në pajtim me nenin 451, paragrafi 1 dhe nenin 452, paragrafët 1 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), duke kontestuar aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 244/10 dhe të Gjykatës Supreme, AP-Kz nr. 61/2012, me pretendimin se këto aktgjykime përmbajnë *”shkelje esenciale të dispozitave të KPPK [...] shkelje tjera të dispozitave të KPK, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës [...].*
19. Më 2 prill 2014, Gjykata Supreme aprovoi Aktgjykimin P.m.l. nr. 194/2013, me të cilin u refuzua kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si e pabazuar, dhe konstatoi:

*“Gjykata Supreme e Kosovës parapraakisht i referohet nenit 432 të KPP (nenit 451 paragrafit 2 të KPPK-së), i cili përcakton se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm dhe gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e shkeljeve eventuale në interpretimin apo zbatimin e ligjit.
[...]*

*Sipas nenit 436 të KPP-së (neni 451 i KPPK-së), Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve të ligjit material apo të procedurës të cilat avokatet mbrojtës i pretendojnë.
[...]*

Përveç kësaj, gjatë vlerësimit të saj Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur shkelje procedurale në aktgjykimet e kundërshtuara të cilat duhet të merren parasysh ex officio”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme P.m.l. nr. 194/2013, i 2 prillit 2014, duke refuzuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër], të drejtat e tij të garantuara me nenin 6 të KEDNJ dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: DUDNJ).

21. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave nga neni 31 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Me vendimet e sipërcituara parashtruesi konsideron se i janë shkelë të drejtat në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ngase gjatë gjykimit nuk është provuar së parashtruesi i kërkesës me veprime apo mos veprime individuale, ka qenë pjesë e krimit të organizuar apo ka bashkëpunuar në bashkëkryerje të veprës siç parashihet me nenet 274, par 4, e lidhur me nenin 23, të KPK-së, dhe në procedurën ankimore ka pranuar fajësinë dhe dënimin për vepër penale kontrabandim me emigrantë, kurse me aktgjykimet kontestuese është shpall fajtor edhe për vepër penale krim i organizuar”*.
22. Në lidhje me shkeljet e dispozitave të tjera kushtetuese, përkatësisht nenin 24, nenin 33 dhe nenit 34, parashtruesi vetëm i përmend ato si shkelje të pretenduara, por nuk ofron argumente apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë:

“[...] se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 244/2010, të dt. 17. qershor 2011, dhe aktgjykimet e instancave më të larta Gjyqësore që e kanë vërtetuar lartësinë e dënimeve të shqiptuara edhe sipas mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, ka shkelje të kushtetutës dhe të ligjit në aplikim, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe ekziston disproporcioni në ashpërsinë e dënimit me veprën penale, në dëm të ankuesit, dhe për veprën që i është vënë në barrë krim i organizuar nuk është provuar me prova se parashtruesi ka qenë pjesëtar i organizatës kriminale me ndonjë veprim apo mos veprim individual të tij.

Të njëjtat aktgjykime të shfuqizohen sa i përket krimit të organizuar nga neni 274, par. 4, e lidhur me nenin 23 të Kodit penal të Republikës së Kosovës, dhe rasti të ri gjykohet në mënyre të pa anshme dhe në pajtim me provat”.

Pranueshmeria e kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të parashtrorë kërkesë në Gjykatë, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit përcakton se *“Kërkesa parashtrorë brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”*.
26. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka filluar procedurat gjyqësore në gjykatat e rregullta, përkatësisht në Gjykatën e Qarkut dhe më

vonë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 23 maj 2014, dhe ai paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, më 12 shtator 2014.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e aplikueshëm, dhe se kërkesa është paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajve.
28. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullave 36 (1) d) dhe 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

A. Sa i përket pretendimeve në bazë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

29. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përballet me akuzat në të gjitha shkallët e gjykatave të rregullta, ku ai e ka ushtruar të drejtën për të paraqitur mbrojtjen e tij, dhe ka shfrytëzuar mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme, në përgjigje ndaj pretendimeve të bëra nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me vendimin për dënim, është i qartë, i arsyetuar dhe i drejtë.
30. Lidhur me pretendimet e parashtruesit që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për atë sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërisë).
31. Gjykata Kushtetuese gjithashtu rithekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu, edhe rastin KI70/11, të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).

32. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta në përgjithësi dhe shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, e miratuar me 10 korrik 1991).
33. Gjykata konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

B. Sa i përket pretendimeve nga neni 24, 33 dhe 34 të Kushtetutës

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i ka përmendur dhe ka përshkruar përmbajtjen e dispozitave kushtetuese që garantojnë barazinë para ligjit, parimin e Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale dhe E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet qartë se si dhe pse ai është trajtuar ndryshe, si është shkelur parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit ose përse ai konsideron se ai është gjykuar dy herë për të njëjtën vepër penale.
35. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon për shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë argumente bindëse dhe të pakontestueshme për pretendimet e tij, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. KI198/13, parashtrues *Agjencia e Privatizimit të Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
36. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument bindës, që tregon se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si nenet e referuara të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe DUDNJ-së mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d) dhe 36 (2) b dhe d) të Rregullores së punës, më 21 janar 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën :
 - a. Në lidhje me pretendimet në pikën A), të papranueshme sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij kushtetuese;
 - b. Në lidhje me pretendimet në pikën B), të papranueshme sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani